



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 58 Prot

Tiranë, më 17.04, 2012

VENDIM Nr. 192, dt. 17.04.2012

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 17.04.2012 mbasi shqyrtoi "Raportin e vëzhgimit intensiv arkeologjik" paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, për Projektin: "Ndërtimi i "HEC-ve Kozel, Shtikë, Helmës", Ersekë, mbi bazën e kërkesës së Subjektit "Hydro Energy Transformers Helmës sh.p.k." Korçë,

VENDOSI :

- I. Të miratojë "Raportin e vëzhgimit intensiv arkeologjik" përgatitur nga **Agjencia e Shërbimit Arkeologjik** në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Korçë, për Projektin: "Ndërtimi i hidrocentraleve "HEC-et Kozel, Shtikë, Helmës" në rrjedhën e përrenjve Kozel, Shtikës dhe të Sagjeve, Ersekë", paraqitur nga Subjekti "Hydro Energy Transformers Helmës sh.p.k.", Korçë.
- II. Të realizohet mbikëqyrja arkeologjike gjatë procesit të zbatimit, nga **Agjencia e Shërbimit Arkeologjik dhe Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Korçë** bazuar në kontratën dypalëshe midis "Hydro Energy Transformers Helmës sh.p.k." dhe **Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik**.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

ALDO BUMÇI

MINISTËR

SEKRETAR I KKA

ROLAND OLLI

